



# CSR 2018

BANKAT PËR SHOQËRINË



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



# VJET RAPORT CSR

BANKAT PËR SHOQERINË



# PARATHËNIE

## I nderuar lexues,

Në duart tuaja një botim tjetër i Shoqatës Shqiptare të Bankave, për të pestin vit radhazi, si një risi në treg. Ndryshe nga botimet e tjera për produkte, shërbime, investime, fitime, etj., ky botim është shumë specifik. I nisur si kontribut i bankave në shoqëri në kuadrin e politikave të përgjegjësive sociale të korporatës, ai është zgjeruar me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Bankat i kanë mbështetur njëzëri këto objektiva dhe secila, nga viti në vit, po e gjen veten më mirë të përfshirë.

Më lejoni vetëm t'ju përmend që, të fokusuara dhe në mbështetje të këtyre objektivave, gjatë vitit 2018:

- objektivi #2, janë dhënë rreth 30 milionë euro kredi për agrobiznes;
- objektivi #3, bankat kanë shpenzuar 1.25 milionë euro për sigurimin e shëndetit të punonjësve të tyre;
- objektivi #5: 68% e punonjësve të industrisë bankare janë femra, të cilat mbajnë 56% të pozicioneve drejtuese të kësaj industrie;
- objektivi #7, 62 milionë euro për efikasitetin në përdorimin e energjisë dhe projektet e energjisë së rinovueshme;
- rreth 400 milionë euro për SME, sipas objektivit #8;
- 5.5 milionë euro për e-banking dhe mobile banking, në zbatim të objektivit #9; dhe
- 1.4 milionë euro për industrinë e peshkimit sipas objektivit #14.

Këtyre u duhet shtuar edhe pjesëmarrja me rreth 1.5 milionë euro për sponsorizime, donacione, ndihma e kontribute në interes të komunitetit, shoqërisë, në sektorë të veçantë të shëndetit, arsimit, kulturës, artit, nxitjes së novacionit, etj.



Kjo panoramë tregon më së miri se bankat nuk janë thjesht njësi biznesi, por ato janë edhe pjesëtarë të shoqërisë, që jetojnë, ndjejnë dhe kontribuojnë për përparimin e shoqërisë.

Të gjitha këto, dhe më shumë se aq, të detajuara, do t'i gjeni në këtë publikim, i cili nga viti në vit po përmirësohet. Ne jemi të ndërgjegjshëm se mbetet shumë punë për të bërë për metodologjinë e matjes më të mirë të kontributit dhe rezultatit për çdo objektivi. Por puna ka filluar. Jemi të bindur se shumë më mirë do të bëhet në vitet e ardhshme.

Duke ju uruar një lexim të këndshëm, shpresoj me siguri që diku do të gjeni veten tuaj.

Me respekt,

**Silvio Pedrazzi**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Silvio Pedrazzi', written in a cursive style.

Kryetar

Shoqata Shqiptare e Bankave

## Përmbajtja

<b>OBJEKTIVI 1</b>	Pa Varfëri .....	6
<b>OBJEKTIVI 2</b>	Zero Uri .....	9
<b>OBJEKTIVI 3</b>	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie .....	12
<b>OBJEKTIVI 4</b>	Arsim Cilësor .....	15
<b>OBJEKTIVI 5</b>	Barazi Gjinore .....	21
<b>OBJEKTIVI 7</b>	Energji e Përballueshme .....	22
<b>OBJEKTIVI 8</b>	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike .....	23
<b>OBJEKTIVI 9</b>	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë .....	28
<b>OBJEKTIVI 10</b>	Zvogëlim i Pabarazive .....	31
<b>OBJEKTIVI 11</b>	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme .....	33
<b>OBJEKTIVI 12</b>	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm .....	36
<b>OBJEKTIVI 13</b>	Veprim për Klimën .....	37
<b>OBJEKTIVI 14</b>	Jeta nën ujë .....	39
<b>OBJEKTIVI 15</b>	Jeta në Stere .....	40
<b>OBJEKTIVI 17</b>	Partneritet për Objektivat .....	41
<b>ART, SPORT &amp; KULTURË</b>	.....	46



## OBJEKTIVI #1 Pa Varfëri

Rreth

**30 000** euro

kontribut në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modelet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankingun për 2,5 miliard të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare, si dhe mikro-sigurimin për rritjen e mbrojtjes sociale.

Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe personat e cenueshëm, që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe formave të tjera të pronës, trashëgiminë, burimet natyrore, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikro-financën.

### PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania** bashkëpunoi me Fondacionin "Fundjavë Ndryshe" dhe nëpërmjet përfshirjes institucionale, si dhe kontributit të shumë punonjësve të saj, mundësoi një mjedis të ri banimi, për një jetesë më dinjitoze për familjen Buçi në Paskuqan.

**Alpha Bank Albania**, gjatë festave të fundvitit, ka shpërndarë ndihma për t'i ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë:

- Mbështeti Kryqin e Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, për organizimin e një dreke në ambientet e Qendrës Sociale të Kryqit të Kuq, për 100 fëmijë jetimë që jetojnë në komunitet si dhe shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet e këtyre fëmijëve.





- Mbështeti Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Zyra Rajonale Gjirokastrër, në organizimin e një aktiviteti festiv për fëmijë që trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe për fëmijët e punonjësve të Agjencisë.

**American Bank of Investments** dhe **Intesa Sanpaolo Bank Albania** mbështetën Drejtorinë e Policisë Tiranë në kuadër të aktiviteteve që u zhvilluan me rastin e festave të fundvitit 2018, për familjet dhe fëmijët e policëve të rënë në detyrë.



Më 18 tetor, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Varfërisë, **FIBank Albania** u angazhua në një aktivitet humanitar në Qendrën Sociale Tiranë, i cili synon të ndihmojë familjet në nevojë, të moshuarit e vetmuar dhe fëmijët, të cilët janë të përjashtuar për shkak të situatës së tyre sociale ekonomike të vështirë, papunësisë, dhunës, të neglizhencës apo diskriminimit dhe nuk përfitojnë përkujdesjen apo shërbimet e nevojshme. Punonjësit e FIBank Albania u organizuan me personazhe të njohur të showbizit shqiptar dhe vullnetarët e Kryqit të Kuq, duke ofruar shërbimin e tyre.



**Raiffeisen** mbështeti Fondacionin "Fundjavë Ndryshe" në projektin e shpërndarjes së sobave të drurit për familjet në nevojë në disa zona të Shqipërisë. U shpërndanë 10 soba për familjet në nevojë në Durrës, 20 soba në Pogradec, 30 në Tiranë, 6 në Fushë Krujë dhe 15 në Shkodër. Kjo shpërndarje përkoi me festat e fundvitit, duke i falur këtyre familjeve pak nga atmosfera e festave.

**Tirana Bank** u ndodh pranë fëmijëve jetimë në komunitet. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, mbështeti ditën ndërkombëtare të fëmijëve jetimë dhe 1 Qershorin, ditën ndërkombëtare të fëmijëve.



## OBJEKTIVI #2 Zero Uri

Financim i agro bizneseve

**29 576 275** euro

Rreth

**8 000** euro

kontribut në mbështetje të institucioneve për arritjen e objektivit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.

Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh. financimi i farës dhe risive në mikro-ushqyerje).

Sigurimi i aksesit për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cenueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.

### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** dhe **Banka ProCredit** kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Institucionet ranë dakord të bashkëpunojnë në kuadër të projekteve të financuara nga BE dhe Qeveria Shqiptare, si dhe Skemave Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi. Bankat ofrojnë financime të veçanta që mbulojnë investime në objekte agro-turizmi, investime në makineri që nxisin prodhimin e produkteve Bio, hapjen dhe rindërtimin e restoranteve që shërbejnë si pika agro-turizmi, financimin e nevojave të përkohshme me likuiditet dhe kapital pune.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania**, pas një përvoje të gjatë në financimin dhe mbështetjen e agrobiznesit, banka vjen







me një projekt të ri për financimin e agro-turizmit në Shqipëri nëpërmjet 4 produkteve të reja: 3 hua për investime dhe 1 paradhënie bankare.

## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania** mori pjesë në veprimtarinë: “Rrathë dhurues”, organizuar më 6 dhjetor 2018 nga Partners Albania, ku individë dhe biznese u bënë së bashku për të mbështetur 3 kauza sociale, të cilat synojnë përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë. Tri organizata, tri nisma në tre qytete, për të mbështetur fëmijët!  
Alpha Bank Albania mbështeti projektin “Adopto një terapi” të Down Syndrome Albania.



Në Ditën e Krishtlindjes, **American Bank of Investments** iu bashkua nismës së lëvizjes Ecovolis, për t’i dhënë pak më shumë atyre që kanë më shumë nevojë. Në sheshin “Nënë Tereza” u mbledhën me qindra njerëz në vështirësi, në varfëri, në pamundësi, ku stafi i bankës, dha kontributin e tij vullnetar.

Kthyer tashmë në një traditë, **American Bank of Investments** festoi Ditën e Falënderimeve, së bashku me njerëzit në nevojë në Qendrën Sociale nr. 6 dhe pranë ambienteve të Kryqit të Kuq, në mensën sociale në Tiranë.



**ProCredit Bank** bleu 1000 kartolina, të pikturuara nga SOS Fshatrat e Fëmijëve. Kartolinat iu shpërndanë institucioneve, klientëve dhe partnerëve të tjerë, duke ndarë në këtë mënyrë nismën dhe duke ftuar njerëz të tjerë për të menduar dhe ndihmuar këtë kategori.

Në kuadër të “Ditës botërore kundër urisë”, **Tirana Bank** në bashkëpunim me SPAR Albania dhe me mbështetjen e Kryqit të Kuq Shqiptar, bënë të mundur përgatitjen e 100 shportave me ushqime bazë për familjet në nevojë të zonës së Tiranës. Shpërndarja e ushqimeve u krye në mjediset e Kryqit të Kuq, dega Tiranë.

Gjatë muajit prill, stafi i degëve të **Union Bank** në Durrës u mobilizua për të mbledhur ndihma ushqimore dhe veshje për familjet në nevojë. Punonjësit e bankës dorëzuan ndihmat e mbledhura në mënyrë vullnetare pranë shtëpive të familjeve të varfra nëpërmjet koordinimit me “Fundjavë Ndryshe”.

## OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie

Bankat ofrojnë për punonjësit e tyre skema të sigurimit shëndetësor

**1 250 000** euro

**54 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.

Shqyrtimi i hartimi të politikave që përfshijnë shërbime të parasë së lëvizshme për transferimin efikas të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me qasjen në kujdesin shëndetësor shtetëror.

Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.

Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurt pune.



### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

#### Alpha Bank Albania

- Në Ditën e Vullnetarizmit mbështeti fondacionin "Ti je një luledielli", ku në datën 18 maj, 419 punonjësit e bankës u angazhuan duke veshur simbolin e kësaj nisme përgjatë të gjithë ditës së punës.
- Në datën 20 maj, pranë Liqenit Artificial të Tiranës, u organizua një veprimtari me fëmijët e stafit të bankës si një mesazh solidariteti për bashkëmoshatarët e tyre me sëmundje të ndryshme gjaku.



- Mbështeti Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Spitalit “Ih-san Çabej” Lushnje, për blerjen e një pajisjeje laboratorike koagulator, për kryerjen e ekzaminimeve për pacientët e spitalit.

### American Bank of Investments

- Mbështeti fushatën “Bashkë kundër kancerit të gjirit”, zhvilluar nga organizata YWCA në Shqipëri në datë 20 mars 2018 në Muzeun Historik, ku u organizuan disa veprimtari në kuadër të dhjetëvjetorit të kësaj organizate. Banka mbështeti veprimtarinë e zhvilluar në qytetin e Korçës, në sheshin përpara Katedrales, nën moton: “Beteja kundër kancerit të gjirit vazhdon...”.
- Mbështeti qendrat shëndetësore të qytetit të Durrësit, ku bashkë me stafin mjekësor dhe 18 studentë të infermierisë së Universitetit të Durrësit, ishin të pranishëm gjatë gjithë sezonit veror për të asistuar me ndihmën e parë dhe këshilla, pushuesit e qytetit të Durrësit. Rreth 26 qendra shëndetësore ishin aktive gjatë sezonit veror në zonat turistike, me shërbim 24 orë.

### Banka Kombëtare Tregtare

- Zgjedhi që të jetë pranë qytetarëve që zgjedhin të trajtohen pranë Klinikës Stomatologjike Universitare në Tiranë. Përmirësimi i kushteve të punës së stafit duke dhuruar disa kompjuterë për ambientet e tyre sjell gjithashtu përmirësime edhe në cilësinë e shërbimeve që do të marrin pacientët e kësaj klinike.



- Mbështeti procesin e restaurimit të Drejtorisë së Shëndetit Publik në Gjirokastrë, duke dhuruar aktive për mobilimin e duhur të mjediseve të institucionit.
- Mbështeti konkursin e parë ndërkombëtar Karate të organizuar në Shqipëri, ku ekipet nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia u mblodhën në sallën “Feti Borova”, ndërsa konkurruan në kata (demonstrata) dhe kumite (ndeshje).

Në ditën Botërore kundër Kancerit, më 4 shkurt, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** iu bashkua lëvizjes globale në këtë ditë nën thirrjen: “Ne Mundemi, Unë Mundem!” dhe një mesazh ndërgjegjësues u shpërnda tek të gjithë punonjësit e saj.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** shpërndau një kartolinë dhe video ndërgjegjësuese në datën 31 maj, për ditën Botërore PA DUHAN, nën moton e OBSH-së: Zgjidh shëndetin, jo duhanin!

**Raiffeisen** mbështeti sektorin e shëndetësisë, me projektet:

- Rikonstruksione të pjesshme të spitaleve dhe qendrave shëndetësore në disa qytete të Shqipërisë: Dibër, Fier, Sarandë për rikonstruksionet e tyre të pjesshme.
- U mbështetën me pajisje dhe me rikonstruksione qendrat shëndetësore në Tepelenë, Luftinj, Pogradec, Devoll, Mat, etj.

**ProCredit Bank** mbështeti Bashkinë Tiranë në mundësimin e rivitalizimit të 6 “bisedkave” me gjelbërim. Këto janë mjedise të dedikuara përgjatë Parkut të Liqenit Artificial Tiranë dhe janë në funksion të qytetarëve të çdo grupmoshe që vizitojnë këtë park.

### Union Bank

- Mbështeti spitalin e qytetit të Kukësit, duke financuar blerjen e disa aparatave për pediatriinë e spitalit dhe të stolave të pritjes për mjediset e përbashkëta të kompleksit spitalor.
- Në muajin dhjetor, zgjedhi të urojë klientët dhe bashkëpunëtorët e saj nëpërmjet kartolinave të urimit, të përgatitura nga Fondacioni Spitalor “Nëna dhe Fëmija”. Fondet e mblledhura nga këto kartolina shkojnë në ndihmë të nënave të reja dhe fëmijëve të porsalindur në kushte të vështira ekonomike.



*Sigurimi i jetëve të shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë dhe në të gjitha moshat.*

## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania, American Bank of Investments, Banka Kombëtare Tregtare, FIBank Albania** mbështetën ½ Maratonën e Tiranës 2018, ku u mbledhën mijëra njerëz nga Tirana, rrethe të tjera të Shqipërisë dhe shumë të huaj.

**American Bank of Investments** mbështeti edicionin e parë të Maratonës së Vrapimit Malor (trial run) në malet e Voskopojës, në datë 21 tetor, një veprimtari dyditore që solli një ndërthurje të natyrës, vrapit dhe turizmit.



**SË BASHKU PËR JETËN  
DHUOJMË GJAK!**

19 Dhjetor, tek Kullat Binjake



**Fibank**  
First Investment Bank

### Dhurim vullnetar gjaku

Kjo nismë synon të motivojë individët që të dhurojnë gjak rregullisht në mënyrë vullnetare nëpërmjet bankave të mirë-organizuara për dhurimin e gjakut.

Mbështetur nga: Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, FIBank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB), Raiffeisen, Tirana Bank.

## OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

Kredi për studentë  
**360 000** euro

**144 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit



### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunim me institucionet financiare dhe qeveritë për të rritur dhe/ose investuar në financimin novator për projektet e arsimit.

Zgjerimi i aksesit dhe shfrytëzimi i kursimeve personale dhe produkteve të kredisë për t'u ardhur në ndihmë familjeve në planifikimin dhe financimin e shpenzimeve të arsimit.

Ofrimi i këshillimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e marginalizuar për përmirësimin e rezultateve në mësim dhe aksesin e industrisë në rrjetin e talenteve të larmishme, çka ofron modele thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale.

Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi të caktuara, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.



### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Alpha Bank Albania** mbështeti Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies në Godinën A, Godinën B dhe Zyrat e Administratës të këtij Fakulteti. Banka u vlerësua me Diplomën e Mirënjohjes nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, për "Kontributin dhe mbështetjen e pakursyer ndaj Fakultetit për arritjen e objektivave akademike dhe universitare".




## *Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë!*

**American Bank of Investments** mbështeti mbrëmjen gala për mbledhjen e fondeve “Mbështesni historinë e suksesit të radhës”, organizim i R.I.T. Kosovo, në 15 maj në Prishtinë, i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë që certifikon studimet me diploma amerikane që njihen në të gjithë botën. Banka dha 3 bursa studimi për studentët e talentuar, por në vështirësi financiare.

**Banka Kombëtare Tregtare** vijoi mbështetjen për institucionet arsimore:

- Dhuroi aktive për “Institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë”, duke bërë të mundur që tani të gjithë nxënësit të kenë kushte më të mira të të mësuarit.
- Sponsorizoi konkursin e përvitshëm të pikturës të RSU Nr.1, duke qenë sponsori i vetëm, për disa vjet, që mbështet studentët më të talentuar të Universitetit të Arteve.
- Mbështeti aktivitetin e fundvitit në qytetin e Vlorës, ku morën pjesë qindra maturantë të diplomuar të shkollave të mesme.
- Mbështeti DAR Qarku Tiranë në organizimin e projektit vjetor sportiv për Shkollat e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë gjatë mbylljes së vitit shkollor.
- Në 1 Qershor, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, iu bashkua festës për nxënësit e ciklit parashkollor të shkollës “Mustafa Kemal Atatürk”.
- Gjatë muajit gusht, mbështeti Ambasadën Turke në organizimin e një udhëtimi të posaçëm në Edirne për 35 studentë dhe 5 mësues. Këta studentë patën mundësinë të vizitojnë këtë qytet të veçantë të Turqisë të famshëm për xhamitë, kupolat dhe minaret e shumta.
- Dhuroi mobilie dhe pajisje zyre për Zyrën Arsimore Kamëz.
- Në 29 tetor, mbështeti Gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, për vënien në skenë të një shfaqje në kujtim të poetit dhe shkrimtarit të njohur shqiptar, Migjeni, me rastin e 80-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta.
- Sponsorizoi blerjen e pajisjeve elektronike për të përmirësuar mësimdhënien në shkollën 9-vjeçare “Gjon Ndoci”, Bushat.
- Mbështeti Universitetin “Luigj Gurakuqi” në organizimin e një grupi aktiviteteve gjatë 5 ditëve me rastin e 25-vjetorit të hapjes së tij.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, mbështeti organizimin e disa aktiviteteve informuese me tematikë “Informimi mbi programin Erasmus + ISM dhe nxitjen e studentëve për t’u përfshirë në këto programe”.





**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD)** organizoi ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP). Ceremonia u zhvillua në Durrës, në ambientet e reja të kampusit të UAMD.

Bashkëpunimi 11 vjeçar midis **BKT** dhe **FASTIP** nxjerr në pah vit pas viti suksesin e këtij sistemi arsimor unik në Shqipëri. Një kënaqësi e veçantë, e dhuruar nga BKT, për studentët diplomantë dhe prindërit e tyre për këtë vit 2018, ishte punësimi i të gjithë grupit të vitit të III prej 16 studentësh në periudhën Korrik - 1 Shtator, shumë më përpara se të diplomoheshin!

### **Credins Bank**

- Mbështeti botimin e Katalogut “Gimjani – Pulla Shqiptare”. Në prag të 105 vjetorit të pullës së parë shqiptare, autori Muharem Gimjani sjell katalogun e pullave të emetuara nga Posta Shqiptare në vitet 1913 – 2017.
- Gjatë muajit shtator, zgjodhi të jetë pranë fëmijëve që nisin vitin e ri shkollor. Nën moton: “Unë di të kursej”, banka ka ideuar një udhëzues për prindërit dhe fëmijët e ciklit 9-vjeçar.
- Mbështeti ekipin e të rinjve që përfaqësoi Shqipërinë në Olimpiadën e Robotikës në Meksikë.
- Mbështeti Tirana Business University në nismën: “Sipërmarrësit e së Nesërmes” dhe “Juristët e së Nesërmes”, e cila kthyer tashmë në një traditë të TBU-së në nxitjen e ideve të reja, frymës së konkursit dhe spikatjen e ideve të biznesit, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e vendit.
- Në Ditën Ndërkombëtare të Kursimit, ishte pranë nxënësve të shkollave 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë” dhe “Shkolla e Kuqe”. Banka dhuroi 1500 fletore, ku gjendej i integruar edhe një udhëzues financiar për prindërit dhe fëmijët e ciklit 9-vjeçar, i quajtur “Unë di të kursej”. Pjesë e angazhimit të drejtuesve të lartë ekzekutivë në Credins është dhe kontributi personal në edukimin financiar të fëmijëve. Monika Milo, Zv. Drejtore e Përgjithshme e Credins Bank, priti një grup nxënësish të klasës së dytë nga World Academy of Tirana, për një bashkëbisedim në zbulim të njohurive të para mbi bankën, kursimin, huan dhe sistemin bankar.

Si një mundësi e barabartë, punëdhënësi vazhdimisht investon në trajnime të stafit. Më 8 tetor, 64 anëtarët e stafit të **Fibank** zhvilluan një trajnim intensiv 6-ditor në bashkëpunim me EPPS Albania, të përqendruar në aftësinë për të negociuar në praktikë, bashkëveprim dhe diskutime me ekipin e shitjeve dhe negociatave të Fibank Albania. Negociatat mund të lehtësojnë marrëdhëniet dhe mund t’ju japin një avantazh pozitiv në shitje dhe biznes. Këto trajnime janë një praktikë e vazhdueshme që



i shërben Fibank për të përmirësuar cilësinë e punonjësve dhe klientëve.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Mori pjesë në veprimtarinë e zhvilluar nga Universiteti Metropolitan i Tiranës, ku prezantoi ofertën speciale të krijuar për mbajtësit e Kartës së Studentit të UMT-së. Studentët e UMT do të përfitojnë Paketën e Studentit FALAS vitin e parë, nëse ata zgjedhin të paguajnë studimet e tyre përmes EDU Kredi, për të cilën mund të aplikojnë në cilëndo prej 34 degëve në Shqipëri.
- Banka mbështeti financiarisht dhe me ekspertët e saj të ICT-së, Projektin “EESTech Challenge Tirana” i EESTEC LC Tirana, në fushën e “Big Data Analysis”. Projekti i nisur 6 muaj më parë, u konkretizua përmes një Hackathon, konkurs në kohë reale i zhvilluar në 15-17 mars 2018, ku morën pjesë studentë nga universitete të Tiranës, të orientuar në drejtimet e Inxhinierisë Informatike dhe Shkencave Komputerike. Në fund të këtij bashkëpunimi, banka punësoi 7 studentë.
- Mbështeti Kampin Rajonal të Inovacionit, të zhvilluar në 9 shkurt në Gjirokastrë nga Junior Achievement of Albania.
- Banka ndau me kolegët dhe ndjekësit në rrjete sociale një mesazh ndërgjegjësues në 21 shkurt 2018, për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare.
- “Auditi i Brendshëm në sektorin bankar në Shqipëri” ishte tema e leksionit të hapur të mbajtur në UET nga Zj. Ediola Bicaku, Drejtore e Departamentit të Auditit të Brendshëm, më datë 16 mars, në kuadër të Javës së Parasë.
- Në vijim të bashkëpunimit me UET, Drejtues të lartë të Bankës Intesa Sanpaolo Shqipëri morën pjesë në takimin e organizuar nga ky universitet në kuadrin e projektit 250+, mbi vlerësimin e ecurisë së programeve Master Profesional dhe Master Shkencor.
- Banka mbështet me anë të materialeve promocionale, Konferencën Studentore të mbajtur në datën 28 mars në mjediset e Hotel Plaza me temë: “Globalizimi ekonomik dhe sfidat e të rinjve”, organizuar nga Universiteti Metropolitan dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës.
- Z. Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe z. Dario Grassani, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv, mbajtën një leksion të hapur në Universitetin e New York-ut në Tiranë mbi “Buxhetimin dhe Ciklin e Monitorimit”.
- “Arti i kursimit”, një mundësi për të mbështetur përfshirjen financiare, përmes edukimit financiar të brezit të ri. Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua për të dytin vit radhazi nismës së suksesshme ndërkombëtare të Grupit Intesa Sanpaolo & Muzeut të Kursimit (Museo del Risparmio),







Galerive Italiane (Gallerie d'Italia) dhe Arkivës Historike, për të festuar së bashku Ditën Botërore të Kursimit në 31 tetor 2018. Intesa Sanpaolo Bank Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit & Rinisë, ndërmorën rolin e mbështetjes së edukimit financiar të fëmijëve dhe adoleshentëve, duke përfshirë vullnetarisht punonjësit e bankës si instruktorë në klasa, për prezantimin e 3 kurrikulave (laboratorëve multimedialë), të përgatitur nga Muzeu i Kursimit në Torino, të krijuara enkas për grup-mosha të ndryshme.

Për të dytin vit u organizua në Shqipëri Parlamenti Evropian i të Rinjve. Këtë vit, **Tirana Bank** ishte mbështetësi kryesor për realizimin e tij, në mbështetje të të rinjve që kanë ardhur nga të gjitha shkollat e mesme të Shqipërisë për të marrë pjesë në konferencën "Tirana 2018", e zhvilluar në datat 16-17 shkurt. Ky event mbledhi së bashku rreth 90 pjesëmarrës, ku 30 prej tyre ishin trajnues për të rinjtë, organizatorë, fotografë, si dhe juria ndërkombëtare. EYP, ose Parlamenti Rinor Evropian, është një organizatë jo-fitimprurëse, e vendosur si platformë në 40 shtete, me objektiv kryesor përafrimin me Bashkimin Evropian, por mbi të gjitha, nxitjen e qytetarisë, mirëkuptimit, barazisë dhe bashkëpunimit me anë të debatit politik.



#### **Raiffeisen** mbështeti:

- Konferencën Kombëtare: "Për Edukimin Financiar", organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më 24 maj 2018, me fokus studentët, të cilët u përfaqësuan me punime të ndryshme për të nxitur diskutimin mbi zhvillimet më të rëndësishme të sotme dhe sfidat me të cilat përballen tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe rëndësinë që edukimi financiar ka për zhvillimin e tyre.
- All Web, edicioni i tretë i konferencës për marketingun digjital në Tiranë u mbajt në tetor, ku morën pjesë 13 folës me një audiencë të mrekullueshme, duke krijuar një tjetër përvojë të bukur dhe të vlefshme për edukimin marketingut digjital dhe SEO.
- Në bashkëpunim me bashkinë Himarë, u pajis laborator i informatikë i shkollës me pajisje kompjuterike.



#### **Union Bank**

- Me rastin e festës së 7 Marsit, Union Bank, me nismën e degës së saj në Kukës, dhuroi për Drejtorinë Arsimore Kukës 40 kompjuterë të vetë bankës, të cilat u shpërndanë për të gjitha shkollat e qarkut.
- Mbështeti të rinjtë duke investuar në të ardhmen e tyre përmes kredive të posaçme me kushte të përshtatshme për financimin e studimeve të larta.

## Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë!

- Dega e Union Bank në Shkodër, në bashkëpunim me shkollën e mesme “Oso Kuka”, organizoi për nxënësit e klasave të 12-ta disa orë edukimi financiar, në kuadër të lëndës së Ekonomisë. Drejtori i degës Shkodër i njohu nxënësit maturantë me mënyrën e funksionimit të sistemit bankar në vend si dhe me produktet dhe shërbimet bankare. Një vend të veçantë në prezantim kishte edhe edukimi i nxënësve rreth praktikave të kursimit dhe menaxhimit sa më i mirë të të ardhurave.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania** dhe **American Bank of Investments** ishin të pranishme në veprimtarinë dy-ditore më të madhe të trajnimit në Shqipëri: “Rruga drejt Suksesit”, nga Vasil Naçi, i cili në vitin e tretë të organizimit priti rreth 2000 profesionistë të fushave të ndryshme.

Ky event synoi nxitjen e aftësive ndër-personale të punonjësve, për sa i përket zotësive dhe eksperiencës. Të ardhurat e siguruar nga shitja e biletave shkuan për bamirësi.



### Java e Parasë në Shqipëri

*Mbështetur nga Alpha Bank Albania, Credins Bank, Intesa Sanpaolo Albania Bank, Union Bank, Procredit Bank, Raiffeisen Bank Albania, ABI Bank and Societe Generale Albania Bank.*

Java e Parasë është një festë mbarë-botërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirë-menduara.

Në datat 12 -18 mars 2018 në Shqipëri u organizua Java e Parasë, nën sloganin “Paraja: Ç’të mbjellësh, do të korrësh!”. Aktivitetet u organizuan në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSh) dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), Junior Achievement (JA), Shërbimit Kombëtar për Rininë (ShKR), shkollave, universiteteve publike dhe jo publike, etj. duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth **5000 fëmijë dhe të rinj, 55 shkolla 9-vjeçare, 14 shkolla të mesme, 8 universitete, 14 qytete.**

**European Money Quiz.** AAB bëhet pjesë e konkursit evropian, i cili u organizua për herë të parë në 2018, me qëllim rritjen e kulturës financiare për fëmijët e moshës 13-15 vjeç.

Alpha Bank Albania, Credins Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB), FIBank Albania, Procredit Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Tirana Bank.

### Lider për 1 ditë!

Në bashkëpunim me Organizatën Junior Achievement Albania, **ProCredit** mbështeti aktivitetin “Lider për 1 Ditë”. Një student i ekselencës nga gjimnazi u caktua që përgjatë gjithë ditës të shoqëronte një ekspert bankar për të fituar përvojë praktike dhe për t’u sjellë si lider përgjatë gjithë ditës së punës.

# OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore



# 100 000 euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit

## MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuara nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.

Rritja e përqindjes së grave në bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave si fuqi punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.

## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**FIBank Albania**  
**#CelebrateHer**

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave kërkon përpjekje të fuqishme, duke përfshirë kuadrin ligjor, për të luftuar diskriminimin e bazuar thellësisht në baza gjinore që shpesh rezulton nga qëndrimet patriarkale dhe normat shoqërore. Në këtë kuadër, Fibank Albania, në bashkëpunim me Fondacionin e Spitalit të Nënës dhe Fëmijës, organizoi një fushatë publike të Flash Mob, e quajtur #celebrateHer "Valsi i Dashurisë" në Sheshin Skënderbe, në 6 mars, me pjesëmarrjen e të rinjve shqiptarë, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave, sidomos gjatë periudhës së tyre të shtatzënisë. Flash Mob publik u organizua me mbështetjen e Shkollës së Baletit të Tiranës, duke përfshirë edhe disa shkolla të mesme.

Gjatë muajit dhjetor, si pjesë e fazës së fundit të fushatës "#CelebrateHer të Fondacionit të Spitalit të Nënës dhe Fëmi-




jës, FIBank Albania ka printuar kartolinat e sezonit së bashku me logon e fondacionit dhe një mesazh për të gjithë partnerët, për të mbështetur nismat për të ndihmuar nënat shtatzëna dhe foshnjat e tyre.

Në ditën ndërkombëtare të gruas, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** ndërmori një fushatë ndërgjegjësuere të brendshme dhe të jashtme, në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Orange the world: #hearmetoo  
Banka iu bashkua fushatës ndërkombëtare: “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, e cila u zhvillua nga data 25 nëntor (Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave), deri në 10 dhjetor (Dita e Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut), e cila bashkon qeveritë, agjencitë e OKB-së, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe individët nga të gjitha vendet e botës, për të organizuar veprimtari ndërgjegjësuere, duke sjellë mesazhin e “Tolerancës Zero për dhunën ndaj Grave dhe Vajzave”.

Banka iu bashkua kësaj fushate me sloganin: “Më dëgjo edhe mua!”, në bashkëpunim me UN Women Albania, duke shpërndarë materiale ndërgjegjësuere për punonjësit dhe për klientët, nëpërmjet faqes zyrtare në Facebook dhe Instagram, si dhe rrjetit të ATM-ve. Dega e Intesa Sanpaolo Bank Albania në rrugën e Barrikadave, më datë 23 nëntor 2018, në orën 17:00 – 21:00, u ndriçua në ngjyrë portokalli, duke iu bashkuar lëvizjes, për të tërhequr vëmendjen botërore të dhunës kundër vajzave dhe grave. #MeToo, #TimesUp, #Niunamenos, #NotOneMore, #BalanceTonPorc.

Me mbështetjen e **Raiffeisen**, më 30 maj, qendra ACT for Society organizoi fazën përmbyllëse të konkursit: “Të jetosh me barazinë gjinore”, i cili synon të nxisë reflektimin e të rinjve mbi situatën aktuale të barazisë gjinore në Shqipëri.

Pritja e ndërgjegjësimit të brezit të ri për rolin gjinor dhe zhvillimin e figurës së gruas, si dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, janë në fokus të Linjës së Këshillimit të Grave dhe Vajzave. Raiffeisen ka mbështetur organizatën: “Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, në veprimtaritë e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e barazisë gjinore. Një ekspozitë që paraqiti Gjeneratën A në Shqipëri, të parë nga sytë e një artisti të huaj profesional Julius Eb, me fokus të veçantë të gratë dhe vajzat. Kjo do të ekspozohet paralel me pikturat dhe fotografitë e vjetra me gratë dhe vajzat nga koha socialiste, ku gratë dhe vajzat portretizohen ndryshe. Ekspozita u hap në dhjetor 2018 në Muzeun Historik Kombëtar.



## OBJEKTIVI #7 Energji e përbalueshme dhe e pastër

**62 000 000** euro

Financim ndaj efikasitetit në përdorimin e energjisë dhe projektet e energjisë së rinovueshme

**10 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Aplikimi i ekspertizës financiare ndaj modeleve të çmimit të energjisë, të cilat përbushin tre objektivat e qëndrueshmërisë financiare, eficientës së energjisë dhe aksesit universal, duke përfshirë veçanërisht shqyrtimin e nevojave për energji të komuniteteve me të ardhura të ulëta.

Nënvizimi i zhvillimeve në fushën e energjisë së rinovueshme, si për shembull plantacionet e mullinjve të erës dhe burimet e energjisë diellore, për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie gjithëpërfshirëse me nivel të ulët karboni.

Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt dhe me shërbime moderne të energjisë, rritja në mënyrë të ndjeshme e pjesës së energjisë së rinovueshme në kombinimin e energjisë së botës, dhe dyfishimi i normës globale për përmirësimin e eficientës së energjisë.



### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Me nismë të **Bankës ProCredit**, u organizua një takim me biznese të interesuara për realizimin e investimeve në impiante fotovoltaike. Në fokus ishte informimi i bizneseve mbi përparësitë e këtyre investimeve, detajet teknike të impianteve dhe mundësitë që banka ofron për realizimin e tyre. Për të dhënë ekspertizën e tyre teknike në këtë fushë dhe

**Sigurimi i lidhjes me energji të përballeshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.**

për të informuar lidhur me këto impiante ishte e pranishme edhe shoqëria EuroElektra - e specializuar dhe e certifikuar për realizimin e këtyre investimeve në vendin tonë. Banka ProCredit është institucioni i parë financiar që ka kryer vetë një investim në panele fotovoltaike në godinën e Zyrave Qendrore dhe që pritet të prodhojë rreth 25 500 kwh/vit energji elektrike.

**Union Bank** merr 6 milionë euro kredi nga BERZH për nxitjen e investimeve në energjinë e gjelbër në Shqipëri. Sektori privat i ndërtimit dhe rezidencial në Shqipëri do të përfitojë nga një akses më i gjerë në financim, falë huas prej 6 milionë euro që Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) i mundëson bankës. Union Bank do t’jua huazojë këto fonde klientëve të saj, në mbështetje të investimeve në projekte me ecuri të lartë efieçience në energji në banesa private, ose në ndërtesa rezidenciale.

Në datat 5-6 tetor, u zhvillua në Tiranë edicioni i dytë i panairit: “Energy Expo & Forum 2018”, organizimi i të cilit pati në fokus energjinë e rinovueshme dhe efieçencën e energjisë. **Union Bank** prezantoi veçanërisht produktin e huas së dedikuar për financimin e paneleve fotovoltaike. Ky panair erdhi edhe në formatin forum-konferencë në organizim, duke trajtuar potencialin e madh që ka në Shqipëri dhe në rajon për të investuar në fus-



## OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

**394 000 000** euro

Kredi për NVM-të

Rreth

**20 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të  
ndryshme në arritjen e objektivit

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkombëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator.

Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime) për pronarët e bizneseve të vogla.

Zgjerimi i financave për "të mesmen që mungon", d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin nga mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të marrin kredi nga sistemi bankar formal.

Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me prejdhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim promovimin e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu performancën e shoqërisë përmes rritjes së diversitetit të fuqisë punëtore.

Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare vendase për nxitjen dhe zgjerimin e aksesit në shërbimet bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.



### PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

#### Panairt e Punës dhe Studimit

nga **American Bank of Investments, FIBank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, Union Bank**

Bankat në Shqipëri kanë mbështetur dhe zhvilluar për shumë

**Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë.**

vite radhazi programe të cilat përqendrohen në uljen e nivelit të papunësisë në vend dhe vazhdimisht ofrojnë mundësi punësimi për pozicione të ndryshme në sektorin bankar, si edhe praktika për studentët. Në kontekstin e mbështetjes dhe nxitjes së punësimit, këto banka morën pjesë në lloje të ndryshme panairesh (panairi i punës, panairi i studimit, panairi i karrierës) të organizuara nga Universiteti Evropian të Tiranës dhe Universiteti i New York-ut.

**Alpha Bank Albania**, më 7 dhjetor 2018, mbështeti zhvillimin e edicionit të parë të Forumit Ekonomik të Tiranës. Ky forum i përvitshëm është një takim i drejtuesve të niveleve më të larta, shqiptarë dhe ndërkombëtarë, të politikës, të korporatave dhe intelektualëve, për të trajtuar sfidat kryesore me të cilat po përballlet Shqipëria dhe bota.

**American Bank of Investments** mbështeti:

- “Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim” në nismën e saj për inkurajimin e zhvillimit të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, në aktivitetin “Prezantim i modeleve të sipërmarrjeve - Partneritet me Biznesin”, në datë 8 qershor.
- Edicionin e dytë të Panairit të bujqësisë, zhvilluar më 12 - 13 tetor 2018, në sheshin “Nënë Tereza”, nën sloganin: “Shqipëria punon tokën”.
- Konferenca e 8-të Shkencore Ndërkombëtare në Universitetin e Durrësit nga Fakulteti i Biznesit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

**Banka Kombëtare Tregtare**, në kuadër të bashkëpunimit me Portin Detar Vlorë, në këndvështrimin e rritjes së përgjegjësisë sociale dhe me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit për komunitetin, financoi prodhimin e veshjeve për punonjësit e portit.

Arritja e një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në çdo moshë është shumë e rëndësishme kur bëhet fjalë për afrimin e bizneseve pranë nevojave të njerëzve. E tillë ishte hapja e degëve të reja të **Fibank Albania** në tre qytete kryesore, përkatësisht në Lezhë, Lushnjë dhe Sarandë. Ky zgjerim do të krijonte të paktën mbi 40 mundësi të reja pune për këto qytete dhe do të nxisë mënyra të reja për të mbështetur familjet shqiptare për qëllimet e tyre personale ose të biznesit nëpërmjet produkteve të Fibank.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania**

- BERZH zgjeron bashkëpunimin dhe Intesa Sanpaolo Bank – Shqipëri rrit mbështetjen ndaj përmes skemës së saj të ndarjes së rrezikut. Marrëveshja e nënshkru-



ar në muajin shkurt në zyrat qendrore të BERZH-it në Londër, në kuadër të Samitit të Tretë të Investimeve në Ballkanin Perëndimor, përfshin një rritje të skemës aktuale të ndarjes së rrezikut nga 10 milionë euro në 50 milionë euro dhe me kohëzgjatje të bashkëpunimit edhe për tre vite të tjera.

- Banka mori pjesë në konferencën kombëtare të OXFAM për projektin dhe analizat e kryera në zonën e Malësisë së Madhe, financuar nga Grupi Intesa Sanpaolo, si pjesë e projektit: “Zinxhiri i vlerave bujqësore gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale në Bosnjë Hercegovinë dhe Shqipëri”, FAI (filiiere agricole inclusive).
- Në kuadër të veprimtarive që Grupi Intesa Sanpaolo organizon për të gjithë punonjësit ishte edhe maratona ndërkombëtare e vrapimit, zhvilluar në Poreč (Kroaci), në datat 24 dhe 25 mars 2018. Katër punonjës të Intesa Sanpaolo Bank Albania morën pjesë në këtë maratonë, e cila përfshinte vrapimet për: Half-Marathon (21 km); Fun Run (14 km); Family Run (7 km).
- Intesa Sanpaolo Bank Albania mundësoi pjesëmarrjen e dy skuadrave sportive të punonjësve, atë të volejbollit për femra dhe futbollit për meshkuj, në veprimtarinë sportive më të madhe ndërkombëtare të Grupit Intesa Sanpaolo. Edicioni sportiv i 2018-ës u zhvillua në Lubjanë.

Në shtator të vitit 2018, **ProCredit Bank** mori pjesë në panairin Virtual të Karrierës, organizuar nga DIHA, me mbështetjen e GIZ dhe Alumniportal Deutschland. Ky panair shërben si një mjet efektiv për përputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës dhe si një platformë për punëdhënës dhe punëkërkues nga rajoni, pavarësisht nga vendndodhja e tyre. Kjo platformë u ofron kompanive një mundësi unike për rekrutimin e profesionistëve edhe me përvojë arsimore gjermane, të cilët janë më se të mirëpritur dhe nga banka ProCredit.



## OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

**5 450 000** euro

Investime ne Mobile Banking, e-banking

**253 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit dhe projekteve në nxitje të inovacionit

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.

Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).

Rritja e aksesit të ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përbalueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe të proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.

### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Në kuadër të mbështetjes të institucioneve të ndryshme, për të promovuar politika të orientuara drejt zhvillimit të kushteve sa më të mira të punës, **Alpha Bank Albania** mbuloi shpenzimet për restaurimin e mjediseve të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik në Korçë dhe Iyerjen e ambi-





entëve në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Devoll.

Në 18 shtator u zhvillua Festivali tregitor i Inovacionit, organizuar nga Dhoma e Tregtisë & Industrisë, Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, me mbështetjen e **American Bank of Investments**. Ky event përkoi me Samitin Botëror të Festivalit në Toronto, Kanada, i projektuar si “Festivali i së Ardhmes në Botë”, organizuar nga Trend Hunter.

**Banka Kombëtare Tregtare** dhuroi pajisje multi-funksionale Print/Scan/Copy për Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit – Rajoni Kukës dhe Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave /Ndërtimeve Informale. Në bashkëpunim me Bashkinë Librazhd, IEVP Peqin dhe Agjencinë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB) Elbasan, u kujdes që dhurimi i pajisjeve të IT-së pranë këtyre instancave të përmirësimit infrastrukturën e IT-së, duke nxitur kështu inovacionin teknologjik në këto institucione.

#### Credins Bank

- Mbështeti Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Nr.3, duke mbuluar shpenzimet për restaurimin e mjediseve së kësaj poliklinike. Banka mbështeti Spitalin Universitar të Traumës, Spitalin Rajonal Shkodër, Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1 dhe Qendrën Shëndetësore Nr. 4, duke restauruar dhe dhuruar pajisje për përmirësimin e kushteve dhe mjediseve të brendshme të këtyre institucioneve, Qendrën Shëndetësore Katund i Ri, Shkozet, duke dhuruar karrige për mjediset e brendshme të kësaj poliklinike.
- Dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, një institucion i veçantë shëndetësor i të burgosurve, Komisariati i Policisë Mallakastër, Drejtoria Rajonale Arsimore Shkodër.
- Dhuroi pajisje elektronike për Prefekturën Tiranë.
- Dhuroi për Bashkinë Kamëz 45 pemë kumbulle, duke kontribuar në shtimin e zonës së gjelbër dhe ofrimin e mjediseve më të këndshme për banorët e zonës.
- Në kuadër të përkujdesjes të vazhdueshme për mirëqenie, progres dhe zhvillim të mjedisit ku ushtron veprimtarinë e saj, banka dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Zyrën Arsimore Kamëz, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mallakastër dhe Njësinë Administrative Nr. 2, Tiranë.
- Credins Bank ka nisur të përdorë makinat elektrike në



## Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

kryeqytet, duke bërë edhe një hap më pranë inovacionit dhe digjitalizimit, falë sistemeve inteligjente me të cilat ato operojnë, por mbi të gjitha, duke ulur ndikimin negativ mbi mjedisin.

- Ka investuar dhe zhvilluar politika për mbështetjen me financim të projekteve në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve jetësore. Banka mbështeti Rezidencën Studentore Universitare Nr. 2 sh.a, Shkollën “Isa Boletini”, IEVP Fushë Krujë, DRSH Dibër dhe Qendrën Shëndetësore Nr. 1, duke restauruar dhe dhuruar pajisje për përmirësimin e kushteve të brendshme dhe për mjediset e brendshme të këtyre institucioneve.
- Dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: AZHBR, Ujësjellës-Kanalizime Mallakastër, Trajtimi i Studentëve, Shtëpia e Pushimit Ministria e Brendshme, Qendra Shëndetësore Nr. 8, si dhe Klubi Shumësportësh “Studenti”.

**FIBank Albania** nisi disa fushata të suksesshme të mediave sociale si “#LumturiaeSaj – e parë në sytë e fëmijëve”. Secila nga këto fushata kishte si fokus kryesor inkurajimin e brezit të ri për të përdorur të dhënat në internet dhe, më e rëndësishmja, për t’i parë mediat sociale si një mjet të ri për mundësitë e investimeve të mëtejshme. Meqenëse fushatat dëshmuuan të jenë shumë të suksesshme, FIBank do të vazhdojë të përmirësojë më tej dhe t’i zbatojë ato në strategjinë e saj vjetore bankare.

“Innovate your way out” është një projekt i pavarur, i iniciuar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, me qëllim nxitjen e projekteve novatore nga studentët. Subjekti i “Inovacionit” ofrohet gjatë semestrit të dytë të vitit të parë për mbi 400 studentë, të cilët studiojnë në fushën e Administrimit të Biznesit dhe Informatikës së Biznesit. **FIBank** mbështeti çmimin e tretë fitues të studentëve së bashku me prezantimin e tyre novator.

Më 16 nëntor, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** mirëpriti në degën e saj të rikonstruktuar së fundmi në Rr. Barrikadave, një grup studentësh të vitit të tretë për Ekonomi-Ndërmarrje të Universitetit Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë” në Tiranë. Kjo vizitë u krye në kuadër të “Ditës së Nëntë Kombëtare të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, PMI DAY - Të Industrializohemi”, organizuar nga sistemi italian i Confindustria në bashkëpunim me Confindustria Albania - Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri. Qëllimi është informimi i studentëve për kontributin që jep industria dhe sipërmarrja në cilësinë e jetës, ofrimi i një kornize për të integruar studi-





min teorik në realitetin prodhues, si dhe informimi i tyre për mundësitë e shumta që ofrojnë sektorët prodhues.

Në datat 18-20 shtator, **Procredit Bank** iu bashkua Festivalit të Inovacionit, me risitë novatore në fushën e teknologjisë, si: platforma DirectBanking, Zona 24/7 dhe të tjera, me thelb ofrimin e një eksperience bankare unike.

Gjate vitit, Procredit Bank ka vijuar blerjen e makinave elektrike.

**Raiffeisen** mbështeti:

- Rrugëtimi i ICT awards u mbyll me mbrëmjen gala të edicionit të gjashtë, një festival idesh dhe kreativiteti që e ktheu mbrëmjen në një moment mjaft të rëndësishëm për inovacionin teknologjik. E gjithë kjo u mundësua nga Raiffeisen, i cili për të gjashtin vit radhazi ka mbështetur të gjithë ciklin e aktiviteteve që u finalizuan në natën finale të dhënies së çmimeve për inovacionin.
- Një konferencë e rëndësishme për transformimin digjital, INFOCOM, erdhi me edicionin e saj të 9-të, në sajë të mbështetjes së Raiffeisen. Një panel me folës ndërkombëtarë, ekspertë në fushën e inovacionit digjital, si dhe një seminar mbi teknologjinë blockchain, ju ofroi studentëve të pranishëm si dhe pjesëmarrësve të interesuar një gamë të gjerë informacionesh të vlefshme mbi transformimin digjital.



Startup Live Tirana zhvilloi për të shtatin vit radhazi edicionin e radhës në mjediset e Fondacionit "Ivanaj". Kjo veprimtari solli ide dhe projekt-ide në frymën e StartUp –it. Ceremonia e mbylljes së këtij organizimi përfundoi me votimin e një jurie të përzgjedhur, të përbërë nga figura të suksesshme të jetës së biznesit, pjesë e së cilës ishte dhe **Banka Societe Generale Albania**. Aktiviteti shpërbleu 5 nga pjesëmarrësit me çmime dhe me mundësi për të vijuar më tej zhvillimin e ideve të propozuara.





## OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

# 40 000 euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit



### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përdorimi i teknologjive të reja, të tilla si shërbimet e pagesave të parave të lëvizshme për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efikase dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.

Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja, të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika "cloud" për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.

Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.

Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.



**American Bank of Investments** mbështeti për të tretin vit këtë mbrëmjen gala "Love is All" e organizuar nga aktivistët e komunitetit LGBT në Tiranë.

Në 23 gusht, në Ditën Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, u organizua në Pallatin e Kulturës, Tepelenë "Sikur Memo", një veprimtari përkujtimore në mje-





diset e ish-Kampit famëkeq të Internimit në Tepelenë. **American Bank of Investments** ishte partnere e kësaj nisme, duke mbështetur jo vetëm financiarisht, por dhe duke i dhënë zë një historie nëpërmjet një përfaqësuesi të ABI Bank.

### Banka Kombëtare Tregtare

Mbështeti Qendrën Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Skraparit, ku trajtohen 15 fëmijë të të dy gjinive, me furnizime dhe roba për fëmijët.

Fëmijët e Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat” edhe këtë vit i festuan festat e fundvitit së bashku me stafin e **Bankës Kombëtare Tregtare**. Shportat e mbushura me dhurata iu dhuruan fëmijëve nën ritmin e aktivitetit të dedikuar për festat e fundvitit.

### Credins Bank

Mbuloi shpenzimet për veprimtarinë e zhvilluar në Burgun e Grave Tiranë dhe dhuroi pajisje estetike për gjithë të burgosurat.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Përgatiti një kartolinë ndërgjegjësuese për të gjithë punonjësit e bankës duke theksuar pjesë të Kodit e Etikës dhe Politikave të Burimeve Njerëzore, të cilat ndalojnë rreptësisht çdo lloj diskriminimi. Ky mesazh u shoqërua edhe me një konkurs (nga UNAIDS), i quajtur “A diskriminon ti?”.

**Raiffeisen**, në bashkëpunim me IEVP Berat, bëri të mundur pajisjen e bibliotekës së burgut me libra. Gjithashtu, në ambientet e jashtme të burgut Fier u ndërtua një kënd lojërash për fëmijët familjarë /vizitorë të institucionit.

N (YOU) FESTIVAL erdhi me edicionin e tij të parë, me qëllim edukimin përmes artit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet sociale dhe shëndetësore, duke e fokusuar edicionin e tij të parë në Sindromën Down dhe integrimin e fëmijëve me këtë sindromë në shoqëri. **Raiffeisen** e mbështeti këtë nismë.

### Kontribute në Fshatin e Fëmijëve SOS, një bashkëpunim jetëgjatë

nga **Banka Credins, Banka Ndërkombëtare Tregtare dhe Tirana Bank**

Bankat vijojnë me angazhimin e tyre për të “adoptuar” disa nga fëmijët e fshatit SOS. Sponsorizimi i jetesës së këtyre fëmijëve është një mbështetje jetëgjatë dhe e vazhdueshme për kujdes të personalizuar dhe promovim për zhvillim, arsimim, kujdes shëndetësor, veprimtari sociale, sportive dhe argëtuese për këta fëmijë.



### Down Syndrome Albania Credins Bank, FiBank Albania, Raiffeisen

Bankat patën kënaqësinë të bashkëpunojë me Down Syndrome Albania dhe “SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë”. Në këtë kuadër, bankat kanë kontribuar në blerjen e kartolinave të fundvitit pranë këtyre fondacioneve, kanë mbështetur veprimtaritë e organizuara në “Ditën Botërore të Sindromës Down” dhe festës së 1 Qershorit.

**FiBank** mbështeti pjesëmarrjen e DSA në NASO (Bulgarian Alliance for Social Responsibility) në Varna, Bullgari, në 2 -17 qershor 2018 në Konferencën: “Ekonomia Sociale si një model efikas për përfshirjes sociale”.



*T'i bëjmë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme.*

# OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

Rreth  
**550 000** euro

investime ne mjediset e bankave për të siguruar akses për të gjithë

Rreth  
**200 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit

## MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Vendosja e bashkëpunimit me palët e interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastruktura e transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.

Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofrimi i stimujve për zbatimin e tyre.

Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.

Përforsimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.

Sigurimi i aksesit universal në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**American Bank of Investments** mbështeti:

- Për festimet e Ditës së Verës, bashkë me banorët e qytetit të Elbasanit dhe shumë vizitorë të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, ishte edhe American Bank of Investments, nëpërmjet stafit të degës së qytetit.
- Banka, me rastin e “Ditës Kombëtare të Trashëgimisë





Kulturore”, mbështeti aktivitetet e organizuara ditën e shtunë më datë 29 shtator:

- Në qytetin e Beratit, vite të tëra historie, kulture dhe trashëgime u shpalosen nëpërmjet ekspozitave, panairit të artizanatit dhe grupeve muzikore nga qyteti i Beratit dhe Gjirokastrës, në sheshin qendror “Teodor Muzaka” dhe Pedonalen e qytetit të Beratit.
- Shkodra priti Muzeun e Stilit Ethnovibe - nga tradita në moderne, në muzeun Marubi dhe në Pedonalen e Shkodrës, ku u ndërthurën tradita me modernen, nëpërmjet krijimeve të stilistëve të suksesshëm shqiptarë në botë, të frymëzuar nga perla të traditës.
- Sponsor i projektit “Smile Albania”, lançuar në mbrëmjen e 24 majit në Amfiteatrin e Liqenit Artificial. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm, publikë dhe privatë. Një aktivitet i cili synon të ofrojë risi drejt eksplorimit të mundësive për të mbështetur turizmin shqiptar, përmes angazhimit të të rinjve.
- “Shkodra Jazz Festival” organizoi edicionin e nëntë në qytetin e Shkodrës, i mbështetur nga American Bank of Investments. Plot 1 javë veprimtari në përkujtim dhe promovim të muzikës jazz. Këtë javë, u organizua për herë të dytë edhe Rock Academy me masterclass-e nga artistë, për të rinjtë e talentuar të qytetit.
- Mbështeti Festivalin: “Muzika Internacionale në Korçë”, në plot 5 ditë veprimtari gjithëpërfshirëse për promovimin e artit dhe kulturës.
- Sponsor i projektit të Bashkisë Korçë: “Stacionet e Gjelbra”, i cili përfundoi më 6 tetor me Festën e Mollës, në fshatin Dvoran. Ky projekt solli gjatë gjithë verës veprimtari festive në disa fshatra të rrethit të Korçës, si: Voskopojë, Drenovë, etj., duke promovuar vlerat e trashëguara kulturore të secilës krahinë.
- Mbështeti turneun e koncerteve “Tinguj Kinemaje”, i Orkestrës Simfonike të RTSh-së, i cili gjatë verës shëtit në zona monumentale dhe turistike në disa qytete të Shqipërisë dhe që kishin në repertorin e tyre muzikë nga filma të huaj dhe shqiptarë, të ekzekutuar nga instrumentistët e talentuar të orkestrës Simfonike të RTSh-së.

Gjatë muajit prill, **Banka Kombëtare Tregtare** bëri një donacion mjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe “Shoqatën Vëllazërore Humanitare Istanbul”. Rialokimi i aseteve të BKT-së mbështet këto institucione në krijimin e ambienteve bashkëkohore.



***T'i bëjmë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme.***

Në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, **Credins Bank** prezantoi përmes një video të shkurtër Ryan-in, një sipërmarrës i vogël, i cili jo vetëm na edukon financiarisht, por edhe na ndërgjegjëson për mbrojtjen e mjedisit.

Me rastin e 1 Qershorit, banka zgjodhi të ishte pjesë e “Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve”, me nxënësit e shkollës “Adem Myrta” në fshatin Shpërdhet, Mamurras, të cilët i dhuruan pavidonit të spitalit onkopediatrik në Tiranë punimet e tyre, të realizuara në seminarin “Fëmijët, Arti dhe Ricklimi”.

**Credins Bank** mbështeti:

- Shoqatën “Eja Në Teatër”, duke mbuluar shpenzimet e vënies në skenë të shfaqjes: “Komedia që Shkon për Dreq”, duke mbështetur kështu artin dhe artistët në Shqipëri
- Shoqatën “Orafilm – Marubi sh.p.k”, përmes mbulimit të shpenzimeve të projektit “Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri – Edicioni 13”, duke kontribuar në bërjen e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** mbështeti financiarisht “Konferenca e Turizmit 2018”, veprimtari kjo e organizuar nga FIAA (Shoqata e Investuesve të Huaj në Shqipëri) me 27 nëntor, në ndihmë të një prej sektorëve prioritarë dhe strategjik të zhvillimit të vendit.

Gjatë muajit prill, **Banka ProCredit** bëri një donacion mjetesh për Bashkinë Tiranë. Këto mjete shkuan në funksion të plotësimit të nevojave të kopshteve dhe çerdheve të Tiranës.

**Raiffeisen** mbështeti:

- Edicionin e dytë të Festivalit REJA, me rastin e përvjetorit të instalimit të Resë së Fujimoto-s në Tiranë, pranë Galerisë së Arteve.
- Nga data 2–7 korrik 2018, shoqata Art-Im-Pulse, me mbështetjen e Raiffeisen, organizoi në kinemanë e Pogradecit edicionin e VIII-të të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë (B3F), e vetmja veprimtari kulturore ndërballkanike në Shqipëri. Këtu morën pjesë me krijimet e tyre qindra artistë nga të gjitha vendet e Ballkanit. Gjatë këtij edicioni, u projektuan 75 filma të gjinive: metrazh i gjatë, i shkurtër, filma eksperimentalë, filma të animuar. Gati një e katërta e filmave ishin krijime të rinjsh nga shkollat e filmit në Rumania, Serbi, Shqipëri, Maqedoni, etj.
- Në kuadër të përmirësimit të kushteve të qytetit, sidomos gjatë sezonit të turizmit, Raiffeisen mbështeti Bashkinë e Pogradecit për pajisjen e parkut të qytetit me stola.

- Për të pestin vit radhazi, nën ritmet e muzikës folklorike dhe gjurmëve të hershme të historisë, Raiffesien mundësoi zhvillimin e “Festivali MultiKulturor Berat”, në mesin e muajit korrik.
- Në bashkëpunim me Bashkinë Himarë u organizua aktiviteti “South Outdoor Festival”, një festival që promovon turizmin në jug të vendit, si dhe vlerat kulturore të zonës. Këtë vit u organizua në Vuno.
- Festivali ndërkombëtar i teatrit “Butrinti 2000” është parë si simbol i ballafaqimit të kulturave dhe i lirisë të krijimit artistik. Ai është arenë e dramaturgjisë së mjeshtreve të mëdhenj, të cilët vijnë dhe aktualizohen prej mbartësve të një realiteti bashkëkohor.



## OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

Bankat ndërmarrin iniciativa të brendshme të cilat ndikojnë në reduktimin e:

Energjisë elektrike / Electricity: ↓

Përdorimit të ujit/ Water consumption: ↓

Karburantit të përdorur për transport / Fuel used for transport: ↓

Përdorimit të letrës/ Paper usage: ↓

Ndotjes së ambientit: ↓

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jete më të qëndrueshme.

Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit efikas të burimeve natyrore.

Ulja në mënyrë thelbësore e prodhimit e mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqërive të mëdha dhe ndërkombëtare, për adaptimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.

Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës, në harmoni me natyrën.

Bazuar në bashkëpunimin me shoqërinë “Green Recycling”, në raportin vjetor 2018, **Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB)** ka publikuar ndikimin pozitiv të Bankës në përmirësimin e shëndetit dhe mjedisit ku ne jetojmë. Janë përgatitur për riciklim 2130 kg letër dhe karton. Kjo bëri të mundur shmangien e emetimeve të CO2 për 2,8 ton. Kjo është e barabartë me:

- mbi 39 pemë të ruajtura ose
- 8,7 kilovat energji të kursyer ose
- 19,2 fuçi me naftë të kursyera ose
- 57,9 kg ndotës ajri të shmangur ose



- 78 metra kub ujë të ruajtur ose
- 7 metra kub hapësirë e ruajtur në landfill

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Mbështeti edhe këtë vit projektin “Shqipëria Punon Tokën - Konsumo Shqip”, i cili ka për qëllim unifikimin e produkteve shqiptare në një hapësirë të përbashkët. Ky është panairi më i madh bujqësor dhe blegtoral që hapi sërish dyert për fermerët, blegtorë dhe sipërmarrës shqiptarë, por edhe për trojet shqiptare jashtë kufirit, si: Kosova dhe Maqedonia.
- Mundësi 3 çmime në konkursin për krijime me materiale të ricikluara: “Ju mund”, të organizuar nga ECO Tirana dhe Bashkia e Tiranës, me synim edukimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme mbi ndarjen e mbeturinave dhe vlerën e riciklimit.
- Ndau një mesazh të veçantë ndërgjegjësues me ndjekësit në rrjetet sociale edhe për Ditën Ndërkombëtare të Ujit, duke e vënë theksin në rëndësinë e tij në përditshmëri, sfidat për të ulur numrin e përmbytjeve, thatësitrat dhe ndotjen e ujërave, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron vetë natyra. Sot, 2,1 miliardë njerëz në botë jetojnë pa akses në ujën e pijshëm në shtëpi.

**Raiffeisen** mbështeti Konferencën e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, e cila u mbajt më 3-4 maj, e vlerësuar si forumi më i madh dhe më i rëndësishëm i bashkëpunimit në kontinentin tonë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke mbledhur së bashku aktualisht 62 anëtarë të akredituar dhe 6 vëzhgues.





## OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Rreth  
**170 000** euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në arritjen e objektivit

Investime në – dhe/ose rritje të financimit për – zbutjen e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik, duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.

Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.



### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Banka Kombëtare Tregtare** kujdeset gjithmonë për natyrën e bukur Shqiptare, dhe në bashkëpunim me Green Line Albania, aksioni i pastrimit në datë 23 nëntor, bëri pjesë të axhendës të gjitha trevat e Shqipërisë për t'u kujdesur për çdo gjë që na rrethon: ajrin, ujin, bimët, madje edhe gjallesat nga më të jashtëzakonshmet që jetojnë në male, dete, lumenj, liqene dhe bukuri të tjera natyrore, duke pastruar çdo cep të Shqipërisë.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** u bë pjesë e nismës globale të Orës së Tokës, duke fiku dritat për një orë në datë 24 mars, në orarin 20:30-21:30! Nën sloganin mbarë botëror #connect2earth, banka fiku dritat e Zyrave Qendrore dhe të reklamës së emrit për 1 orë.

Në Ditën Botërore të Mjedisit, banka ndërmori një nismë ndërgjegjësuese një-javore, përmes kartolinave të fokusuar në përcjelljen e mesazheve rreth ndikimit që plastika ka sot në mjedis, sidomos në dete dhe oqeanë. Komunikimi





## Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij

me klientët dhe publikun u bë përmes ekraneve të ATM-ve, footer në shkëmbimin e e-mail-ve, faqen e internetit të bankës dhe faqeve zyrtare të bankës në mediat sociale.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti nismën kombëtare të Green Line, në veprimtarinë “Let’s Do it! Ta Pastrojmë Shqipërinë në 1 ditë”, më 23 nëntor 2018, në disa qytete të Shqipërisë.

**Raiffeisen** mbështeti:

- ECO Fashion Show 25-26 maj, pjesë e “Street Fest”, organizuar nga Bashkia e Tiranës dhe Ambasada Gjermane, me rastin e 30 vjetorit të bashkëpunimit Gjermani-Shqipëri.
- Mbështeti Forumin e Mendimit të Lirë dhe Korpusin Shqiptar të Vullnetarëve në projektin e tyre “Pastrimi i zonave turistike bregdetare para sezonit turistik 2017, organizimi dhe nxitja e vullnetarizmit si formë veprimi dhe edukimi qytetar e mjedisor”. Në bashkëpunim me AZHBR, mundësoi vendosjen e një sere në ambientet e institucionit, me qëllim edukimin dhe ekspozimin e efektit serë për studentët dhe nxënësit.
- Ecovolis shtoi flotën e biçikletave dhe stacionet për parkimin e tyre, nën projektin “Ecovolis Bike sharing 2018”, falë mbështetjes së marrë nga Raiffeisen.

**ProCredit Bank** përfundoi instalimin e impiantit për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet paneleve fotovoltaike në godinën e Zyrave Qendrore. Energjia e prodhuar nga sistemi fotovoltaike përlloraget të jetë rreth 25 500 kwh/vit dhe të sjellë reduktim të CO2 me rreth 15,4 ton/vit dhe, sipas metodologjisë së zhvilluar nga Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit, është e barasvlershme me 395 pemë të mbjella në vit në zonat urbane. E gjithë energjia e prodhuar do të përdoret për plotësimin e nevojave të vetë godinës së Zyrave Qendrore, e cila është në pronësi të Bankës ProCredit.

Për të reduktuar emetimin e dyoksidit të karbonit në natyrë, banka investoi në 3 makina elektrike për lëvizjen e stafit. Këto makina çojnë në 5 numrin e makinave “Green”, të cilat punojnë me burime alternative energjie.

**ProCredit Bank** risolli në nëntor 2018 një fushatë të brendshme për mbrojtjen e mjedisit, nën moton “Mendo Eko”. Qëllimi i fushatës është që stafi, nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimin, të kthejë në sjellje përdorimin e praktikave eko. Pjesë e kësaj fushate është dhe Projekti “Si të kursejmë letrën”. Ky projekt ka në fokus rishikimin e praktikave dhe proceseve me qëllim reduktimin e përdorimit të letrës në operacionet e brendshme të bankës. Përdorimi i firmës digjitale dhe arkivave elektronike është tashmë një ndër praktikatat më efektive të bankës që ka çuar në përmbushje të këtyre objektivave.



## OBJEKTIVI #14 Jeta nën ujë

**1 410 000** euro

Financim për bizneset e  
rritjes së peshkut

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Të minimizohen dhe adresohen ndikimet e acidifikimit të oqeanëve, duke përfshirë bashkëpunimin shkencor të të gjitha niveleve.

Të rregullohen në mënyrë efektive mbledhja e prodhimit dhe t'i jepet fund mbipeshkimit, peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP) dhe praktikave shkatërruese të tij. Të zbatohen plane menaxhimi të bazuara në shkencë, në mënyrë që të ruhen rezervat e peshkut për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivelet që mund të prodhohet maksimumi i qëndrueshëm, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.

Të ruhen të paktën 10 për qind e zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të bazuara në informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm.



*Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit*

## OBJEKTIVI #15 Jeta në Stere

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

# 11 000 euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në aritjen e objektivit

Përdorimi i metodave novatore financiare për të mbledhur fonde, me qëllim ruajtjen e pyjeve dhe ekosistemeve.

Promovimi i ndarjes sa më të drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe promovimi i aksesit së duhur në këto burime, në përputhje me standardet e vendosura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar.

Mobilizimi i rezervave nga të gjitha burimet dhe nivelet, për të financuar administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ofrimin e stimuljeve të mjaftueshëm për vendet në zhvillim, për progresin e një administrimi të tillë, duke përfshirë ruajtjen dhe pyllëzimin.

**Banka Kombëtare Tregtare** mbështeti “Revolucionin e Gjelbër”, një nismë e Bashkisë Tiranë për gjelbërimin e qytetit, duke sponsorizuar projektin e mbjelljes së pemëve në zonën e Liqenit Artificial.

Mbjellja e pemëve në rrugën e sapo inauguruar në Bashkinë Kamëz erdhi si pjesë e kontributit që BKT dha për nismën e Bashkisë Kamëz: “Jepi jetë Kamzës – Dhuro një pemë”.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** iu përgjigj pozitivisht nismës së organizuar nga Bashkia Tiranë për gjelbërimin e qytetit. 5 pemë bliri dhe 5 pemë gështenje u dhuruan për Rrugën Ismail Qemali dhe Rrugën e Barrikadave, vendndodhje këto të cilat përkujnë edhe me Zyrat Qendrore dhe dy prej degëve të rëndësishme të Bankës.







**Raiffeisen** mbështeti nismën e Bashkisë së Tiranës për pyllëzimin e Tiranës dhe mbjelljen e pemëve më datë 21 mars, në Ditën Botërore të Pyjeve. Me këtë rast, u organizua një ceremoni, ku stafi i Raiffeisen iu bashkua kësaj nisme në mbjelljen simbolike të pemëve.

Po ashtu, u mbështet edhe Prefektura Durrës, për mbjelljen e pemëve në zona të ndryshme dhe rehabilitimi i parkut në Kuçovë.



**Tirana Bank** iu bashkua nismës së Bashkisë Tiranë, duke mbështetur mbjelljen e 60 pemëve dekorative. Kjo nismë është një mënyrë efektive për të ndihmuar qytetin në pashtrimin e ajrit, uljen e ndotjes dhe rritjen e cilësisë së jetës, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm.

**Union Bank** mbështeti aksionin e nisur në muajin prill në qytetin e Elbasanit: "Mbill pemën tënde", duke kontribuar në rritjen e numrit të pemëve të reja. Në bulevardin kryesor "Qemal Stafa", stafi i degës Elbasan dhe ai i marketingut në Union Bank, së bashku me përfaqësues të bashkisë së qytetit, mbollën pemë të reja "Magnolia".



# OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

## 147 000 euro

Mbështetje ndaj institucioneve të ndryshme në aritjen e objektivit



## MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.

Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së shërbimeve financiare të përafuara me OZHQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato qëllime, për optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politikë-bërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrin ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.



## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

### American Bank of Investments

- Mbështetëse dhe partnere financiare e takimit të organizuar në 12 mars 2018 nga Zyra e Komisionarit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me rastin e 10 vjetorit të themelimit të saj.
- Për të tretin vit radhazi, ishte partneri kryesor i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Tiranë, në organizimin e ceremonisë festive me rastin e festës së Pavarësisë së ShBA-





së. Festimeve iu bashkua edhe stafi i ABI Bank. Banka Amerikane e Investimeve është Platinum Sponsor i Dhomës Amerikane të Tregtisë për të katërtin vit radhazi.

#### **Banka Kombëtare Tregtare:**

- Drejtoi për të tretin vit radhazi Tryezën e Rrumbullakët të Shqipërisë “Mobilizimi i Financave për Rritje të Mëtejshme”, në forumin për Evropën Qendrore dhe Lindore organizuar nga EUROMONEY më 17 janar 2018. Konferenca u ndoq nga më shumë se 1100 përfaqësues të qeverive, politikë-bërës, financierë, liderë të korporatave dhe investitorë. Ky forum konsiderohet si një nga ngjarjet më të mira të “networking” për këdo me interes në Evropën Qendrore dhe Lindore.
- Në 10 maj, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi (ATTSO) organizoi Asamblenë e Përgjithshme dhe Banka Kombëtare Tregtare ishte sponsori kryesor i saj.
- Mbështeti financiarisht Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Ankara për organizimin e një feste me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë.

#### **Credins Bank**

- Mbështeti Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH) në organizimin e Konferencës së V-të Farmaceutike. Nën sloganin “Së Bashku për Farmaceutikën”, konferenca synoi një informim edhe më të gjerë dhe diskutim mbi zhvillimet farmaceutike në Shqipëri.
- Gjatë muajit maj, ishte e pranishme në veprimtarinë “Prezantim i Modeleve të Sipërmarrjeve, Rrjetëzim dhe Partneritet me Biznesin” organizuar nga Partners Albania.
- Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, organizoi dhe

mbështeti veprimtari me karakter sportiv, për fëmijët e qytetit të Tiranës pranë parkut të liqenit.

- Rreth 170 studiues nga Shqipëria, rajoni dhe më gjerë, morën pjesë në edicionin e 8-të të konferencës ndërkombëtare të Fakultetit të Biznesit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, me temë “Politikat Ekonomike dhe Integrimi Evropian”, mbështetur nga Credins Bank.
- Gjatë muajit korrik, sponsorizoi veprimtarinë për stafin e Burgut të Drenovës.
- Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Credins Bank, me rastin e festës së fëmijëve, 1 Qershorit, organizoi dhe mbështeti aktivitete me karakter sportiv për të gjithë fëmijët e qytetit të Tiranës pranë parkut të liqenit.

#### **ProCredit Bank**

- Edhe këtë vit mbështeti zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, në kuadër të “Tetorit Gjerman”. Nën frymën kulturës gjermane, “Tetori Gjerman 2018” me moton “Frymëzuar nga Njerëzit”, erdhi me një sërë veprimtarish, si: teatër, ekspozita, filma, takime dhe diskutime të ndryshme, të cilat u shfaqën për publikun gjatë gjithë muajit tetor 2018.
- Edhe këtë vit u zhvillua në Tiranë për herë të nëntë DIHA-Oktobërfest 2018, për të gjithë anëtarët e DIHA-s si edhe partnerët, miqtë dhe institucionet e ndryshme. Staf nga ProCredit Bank, si anëtare e DIHA-s, ishin të pranishëm në këtë veprimtari.

# ART, SPORT & KULTURË

Rreth  
**310 000** euro  
Mbështetje të veprimtarive në fushën  
e artit, kulturës dhe sportit

## Alpha Bank Albania mbështeti:

- Pjesëmarrjen e Fondacionit Kalo Art, me vepra të 16 artistëve shqiptarë, në Panairin Ndërkombëtar të Artit Bashkëkohor që u zhvillua në datat 22-25 nëntor 2018 në Selanik të Greqisë.
- Realizimin e edicionit të 14të të Çmimeve Kult, duke promovuar në këtë mënyrë vlerat kulturore dhe artistike që ky event mbart.

## American Bank of Investments mbështeti:

- Komedinë: “Një engjëll në katin e njëmbëdhjetë”.
- Ekspozitën e Jakup Ferrit “op, op” çelur në shkurt 2018, pranë ambienteve të Tulla Cultural Center.
- Programin: “Virtuozët”, si sponsor i përgjithshëm.
- Koncertin recital: Gaqi Piano Duo “Katër Duar, Një Piano”.
- “Verë dhe Portokalle”, spektaklin shëtitës nga trupa e “Portokallisë” së Top Channel.
- Programin: “Maratona e Këngës” si sponsor i përgjithshëm.
- Monodramën: “Apologjia e Vërtetë e Sokratit”, shfaqur me 29 qershor 2018 në Gjirokastrë.
- “Hostel by Anabel”, një bashkëprodhim i Anabel Entertainment dhe INTV.
- Festivalin e Interpretuesve të Këngës Popullore për fëmijët në qytetin e Fushë Krujës, organizuar në datën 13 qershor.
- Koncertet e mëdha në 1 dhe 3 qershor me Ermal Meta dhe Rita Ora në Sheshin “Skënderbe”.
- Filmin italian: “Rimetti a noi i nostri debiti”, në Kinemanë “Millenium” në datë 21 maj.
- Inaugurimin në datë 4 maj të “Hall of Fame” në teatrin “Aleksandër Moisiu” Durrës, të shoqëruar edhe me premierën “Komedia që shkon për dreç”.
- Master Chef Junior, si sponsor i përgjithshëm.





- Programin “Dancing With the Stars”, si sponsor i përgjithshëm.
- Veprimtarinë përkujtimore në nderim të kompozitorit Tonin Harapi, Artist i Popullit, organizuar në prill nga Universiteti i Arteve.
- Projektin Jonida Podcast, një bibliotekë intervistash, ku do të dëgjohen rrëfime, biseda, intervista ekskluzive dhe interesante me personazhe të njohur ose të panjohur.
- Koncertin veror të Orkestrës dhe Korit të të Rinjve të Tiranës, në datë 23 korrik, sala e Katedrales Ortodokse.
- Mbrëmjen poetike me “Nderin e Kombit” Mirush Kabashi, në interpretimin e Koncertit Recital Poetik “Pogradec o Enkelana”, me rastin e çeljes së sezonit turistik në qytetin e Pogradecit.
- Dren Abazi dhe Zig Zag Orkestra në Amfiteatrin e Tiranës.
- Shpat Deda në turneun: “Ambël e Thartë”.
- Programin “Familja”
- Koncertin “Misa Criolla”
- Takimin mbarëkombëtar të teatrit profesionist “Kadri Roshi”
- Artin shqiptar në Vatikan
- Festivalin e 57-të në RTSh, si sponsor i përgjithshëm

**American Bank of Investments** ishte sponsor i përgjithshëm i skuadrës “Flamurtari” në basketboll për femra, që u shpall zyrtarisht kampione e Shqipërisë.

**Credins Bank** mbështeti:

- Turneun ndërkombëtar të atletikës që u zhvillua në stadiumin kombëtar “Elbasan Arena”.
- Në datën 14 prill 2018, mbështeti koncertin jubilar: “Nostalgji” të organizuar në Sallën e Koncerteve të Katedrales Ortodokse. Gjithashtu, Credins Bank sponsorizoi projektin “Be DiFFeREnt” nga Fondacioni ARKU.
- Federatën Shqiptare të Bilardistëve, në organizimin e Kampionatit të Bilardos 2018.
- Aeronautikën Shqiptare, në organizimin e “Korça Open Air”.

**Raiffeisen** vazhdoi të japë mbështetjen në fushën e Artit dhe Kulturës:

- Teatri i Operës dhe Baletit ka shoqëruar pasditet e kryeqytetit me disa veprimtari cilësore, të mirëpritura nga publiku artdashës, ku ndër to mund të përmendet baleti “Zhizel”, koncerti “Të gjithë e duam Agim Krajkën”, etj. Teatri Kombëtar, ndër të tjera, doli në skenë me shfaqjen “TAG”.
- Një nga veprimtaritë që Raiffeisen mbështet çdo vit është

Pianodrom, e cila filloi në tetor dhe përfundoi në 17 dhjetor.

- “Tre tenorët”, një tjetër traditë e bukur kjo që erdhi në muajin tetor me pjesëmarrje dhe sukses të gjerë në Tiranë.
- Një sërë aktivitete, disa prej të cilave janë kthyer tashmë në traditë, si International Brass Festival, Anifest Rozafa, Festivali Different Trains dhe Tirana Talent. Shumë nga këto aktivitete synojnë jo vetëm mbështetjen e artit, por edhe promovimin e punës së të rinjve dhe fëmijëve, siç ishte dhe organizimi një-javor i konkursit Pianisti i Ri, i cili u finalizua me koncertin e duos pianistike: Harald Ossberger & Christos Maranto, të cilët ishin edhe pjesë e jurisë së festivalit.
- Advantage Austria që solli për herë të parë në Tiranë “Ballon Vjeneze”, e cila u organizua më 21 prill 2018 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, duke sjellë eksperiencën mahnitëse të Valsit Vjenez, muzikës së mrekullueshme dhe performancat artistike nga personalitete të kulturës austriake dhe shqiptare.
- Balkan Jazz Showcase është një festival i mirëfilltë i muzikës jazz, i cili u organizua në Tiranë pikërisht në ditën ndërkombëtare të jazzit, nga një nga emrat me të spikatura të këtij zhanri në Shqipëri, Genti Rushi.

**Union Bank** dhe Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) rinovuan marrëveshjen e sponsorizimit për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit. Marrëveshja e nënshkruar mbulon periudhën 2018-2020 dhe është një vazhdim në nivel të ri i traditës shumëvjeçare të mbështetjes së bankës për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit. Gjatë këtij partneriteti të gjatë, i cili ka filluar në vitin 2010, Union Bank ka qenë pranë skuadrës “Kuç e Zi” në çdo event, fitore dhe sfidë. Rinovimi i marrëveshjes tregon edhe një herë përkushtimin e bankës ndaj sportit dhe futbollit në veçanti, duke mbetur gjithmonë një partner besnik i ekipit të zemrës së çdo shqiptari.

**Union Bank**, duke pasur në vëmendje zhvillimin e sportit, mbështet vazhdimisht pjesëmarrjen e stafit të saj në kompeticione të ndryshme sportive. Banka ka një ekip voleybolli dhe një ekip futbollit, të cilët angazhohen rregullisht në kampionatet amatore në Tiranë. Në 2018, ekipi i futbollit të Union Bank u shpall për herë të dytë fitues i Kampionatit të Mini-futbollit.





